

ELDON GJIKAJ

**NJË KLASIFIKIM I RECEPTIMIT KRITIK TË POEZISË
SË LASGUSH PORADECIT**

Në ndërkohën 1930-1940 Lasgushi ishte nga autorët më të njohur në letërsinë shqiptare. Poezitë e para kishin gjetur vend në organe që botoheshin nga kolonitë shqiptare në mërgim, ndërsa më pas në një pjesë të mirë të revistave që botoheshin brenda Shqipërisë. Ato tërhoqën vëmendjen si ligjërim poetik origjinal, i ndryshëm nga ajo e autorëve të deriasokohshëm. Shqyrtimi i receptimit kritik të veprës së një autori, veçanërisht kur kemi të bëjmë me një autor që sjell modele të reja e për pasojë *provokon sistemin letrar*¹, përbën një çështje me rëndësi të dorës së parë, sepse vendi i një veprë letrare në historinë e letërsisë është i pakonceptueshëm pa pjesëmarrjen aktive të receptuesve që u drejtohet. Sipas Jauss-it, themeluesit të estetikës së receptimit:

“Meqenëse raporti dialogues mes letërsisë dhe lexuesit – i cili mund të kuptohet qoftë si bashkëlidhje mes komunikimit (informacionit) dhe marrësit, qoftë si marrëdhënie mes nxitjes e përgjigjes – kushtëzon në mënyrë vendimtare veprën letrare në veçorinë e saj artistike, sikundër në historicizimin e saj ekziston mundësia për të themeluar mbi të (raportin dialogues, *shën. im - E. Gj*) lidhjen e veprave letrare në hapësirën e historisë së letërsisë”²

¹ Për termin *sistem letrar* Shih: Itamar Even-Zohar, *Papers in Historical Poetics*, Tel Aviv 1978 dhe Itamar Even-Zohar “Polysystem studies”, *Poetics Today*, Vol. 11, nr. 1, 1990. Even-Zohari-i e përkufizon kështu *sistemin letrar*: **“Për teorinë e polisistemit, sistemi letrar, mund të formulohet si: rrjeta e marrëdhënieve, që hipotetizohet se vepron ndërmjet një numri veprimtarish të emërtuara si ‘letrare’, por edhe vetë këto veprimtari të vëzhguara përmes kësaj rrjete”**, *Polysystem Studies në Poetics Today* International Journal for Theory and Analysis of Literature and Communication, Volume 11, number 1 (1990), f. 11-12 dhe f. 28.

² H. R. Jauss, *Perche la storia della letteratura?*, Guida Editori, Napoli 2001, f. 34.

Nga sa më sipër e shohim të domosdoshme një pasqyrë klasifikuese të receptimit kritik të poezisë së Lasgush Poradecit, duke vënë si kufij kohorë fillimet e saj deri në vitin 1944, pas të cilit, për arsye jashtëletrare, ky receptim në pjesën më të madhe deformohet. Me kufijtë kohorë të mësipërm shqyrtimi ynë do të përqendrohet në receptimin e Lasgushit në nivel historik, pasi “mënyra se si një vepër letrare, në momentin historik të shfaqjes, mban, tejkalon, zhgënjën, ose mohon *prijtjen* e publikut të saj të parë, jep qartësisht një kriter për të përcaktuar vlerën e saj estetike”³.

Receptimi kritik i poezisë lasgushiane shfaqet kontrastues, duke përfshirë qëndrime skajshmërisht të ndryshme. Ai mund të klasifikohet në tre tipa vlerësimesh: vlerësime maksimale, deri në glorifikim; përpjekje për një vlerësim objektiv, me luhajtje mes entuziazmit dhe dyshimit; mohimi thuajse i plotë.

Sipas nesh te përfaqësuesit më seriozë të tipit të parë hasim një nivel të admirueshëm të kuptimit të tekstit, te përfaqësuesit e tipit të dytë hasim rrekjen për kuptimin e tij, ndërsa te përfaqësuesit e tipit të tretë ndeshim keqkuptimin ose moskuptimin e këtij teksti.

a. Përfaqësuesi më i spikatur i tipit të parë është Mitrush Kuteli, njëkohësisht edhe botues i dy vëllimeve me poezi të Lasgushit “Vallja e Yjve” 1933 dhe “Ylli i Zembrës” 1937. Në pasthënien e vëllimit “Ylli i Zembrës”, Kuteli bën një analizë tërësore të poezisë së Lasgushit, duke e çmuar atë si një nga vlerat themelore të letërsisë shqiptare. Kuteli e shqyrton artin lasgushian në nivelin formal dhe atë semantik, duke dhënë përfundime që jo vetëm do t’i qëndrojnë kohës, por do të shërbejnë si një bazë e pashpërfillshme për të gjithë ata që do të merren me këtë lëndë pas tij. Në përfundim ai shprehet:

“Në u sgjat edhe kaq, kjo i detyrohet vetëm e vetëm artit-mjeshtër të veprës lasgushiane, e cila prej shumë vitesh e ka robëruar me bukuritë e saj pa shoqe në letraturën shqipe, e me shoqe te ralla në letraturën perbotshme. Përfundimi i tij me mbarimin e këtij vëzhgimi kritik, është se Lasgushi shfaqet e mbetet një kulm vigan, i cili ka për të zotëruar shumë kohë me hijen e vet letraturën dhe mendimin shqipëtar.”⁴

Edhe më herët se Kuteli është Çabej që jep vlerësime maksimale për poezinë e Lasgushit, duke i dhënë atij një vend të barabartë mes

³ Po aty, f. 45.

⁴ M. Kuteli, “Fjala e Editorit”, në Lasgush Poradeci, *Ylli i Zembrës*, Bukuresht, 1939, f. 180.

poetëve që kanë përruar modernitetin në letërsinë më të zhvilluara të kontinentit evropian. Çabej nënvizon origjinalitetin poetik të Lasgushit, ndërsa modelin letrar risues që ai përruron në letërsinë shqiptare, e sheh si një kontribut madhor të domosdoshëm:

“Lasgush Poradeci na hap portën e një jete të re në poezinë shqiptare, një *frisson neuf*, siç pat thënë V. Hugo për vjershat e Baudelaireit, lind e rritet në lëmën e këngës shqiptare një stil i ri, të cilin do ta kërkosh më kot në poetët e tjerë shqiptarë, po më kot edhe në shkrimtarët e huaj nga shkaku i origjinalitetit që shquan këtë poet djalosh”⁵.

Po në këtë linjë është edhe Gjergj Kuka, në një artikull të gjatë botuar në disa numra të gazetës *ARBENIA*, ku shqyrton jo vetëm veçoritë e poezisë së Lasgushit, por edhe mendimin kritik mbi të. Ai kundërshton S. Shundin dhe K. Kokoshin, të cilët shihnin mangësi në nivelin kuptimor të tekstit lasgushian. Edhe për Kukën modeli poetik lasgushian është unik në letërsinë shqipe:

“Lasgushi la çelun një botë të re në vjershën t’onë, me fjalë të tjera ka sjellur vjershën. Aj na paraqitet tepër sensibil; pors i arpi që dridhet në telat e veta përpara ç’do flladi të lehtë, aj mbledh armonitë më të holla, dhe arrin me i ngrijtun më së miri një hymn.”Lajmësit qielluar” me këndue qetësin e natyrës, kullimin e lumtunisë që na mbush shpirtin kur gjindemi para saj”⁶.

b. Një ndër përfaqësuesit e tipit të dytë të receptimit kritik të poezisë së Lasgushit është Stefan Shundi. Ai jep vlerësime maksimale për Lasgushin si poet, por nuk pajtohet kurrsesi me pohimin se është poet popullor dhe poet kombëtar:

“Nuk është popullor Lasgushi; s’mund të jetë, as s’do të mund të bëhet popullor. [...] S’ka mendim më i gabuem se ai i atyneve që i apin për dekoratë këtij djaloshi titullin: poet kombëtar. Lasgushi në ndiesi s’është aspak Shqiptar, natyrisht me këtë duem të thomi se psike-ja e tij duhet të kërkohet jashtë kufijve të Shqipërisë, duke e përdorë këtë fjalë si termë abstrakte”⁷

⁵ E. Çabej, *Mbi poezinë e Lasgush Poradeci*, Gazeta e Re, 22 shkurt 1929, f. 3. Cituar sipas Dr. Eqrem Çabej, *Studime gjuhësore*, vëll. V, Rilindja, Prishtinë 1975, f. 88.

⁶ Gj. Kuka, “Vallja e Yjve”, *Arbenia*, 1936, n. 344.

⁷ S. Shundi, *Lasgush Poradeci*, “Minerva”, N. 7, 1933.

Shundi ndalet gjatë në vështirësinë kuptimore që paraqesin vargjet e Lasgushit, duke pasur parasysh edhe nivelin e receptuesve. Ai e çmon deri të parakohshëm stadin poetik të këtij autori:

“Asht për t’u thanë se që tashti, se populli shqiptar nuk gjëndet ende i përgatitun për të përvehtësue të tillë vjershëtarësh. – Duhet të jesh i thjeshtë, i lehtë, i pagdhendun në formë për me i pëlqye Shqiptarit”.⁸

c. Përfaqësuesi më autoritar i tipit të tretë është Krist Maloki, autori i shkrimit të bujshëm *A asht poet Lasgush Poradeci*, më tepër një polemikë me Kutelin sesa një analizë e poezisë së Lasgushit. Sipas Malokit, Lasgushi nuk e meriton vlerësimin si Poet Kombëtar (Dichter):

“Sepse shka i mungon Lasgushit në një mënyrë fort të çuditëshme, por edhe të dukëshme, asht njajo lidhni e ngushtë dhe njajo vuejtje e perbashkët me kombin e vet. Lasgushi shkruen shqip dhe shkruen ndoshta bukur e paster, porse vepra e tijë nuk permban, asnjë paraqitje, asnjë fytyrë dhe asnjë ngjarje, ku mund t’u shifte shpirti i kristalizuem i Kombit Shqiptar”⁹.

Në vijim të kësaj teze Maloki rreket të provojë me shembuj të ndryshëm mospraninë e elementit shqiptar në poezinë e Lasgushit dhe t’i veshë asaj karakterin “e një poezijë të hollë, por edhe të një poezije pa substancë”¹⁰. Megjithatë autori i njuh ndonjë vlerë si përshembull muzikalitetin e vargjeve.

d. Përveçse në shkrimet me objekt shqyrtimi poezinë e Lasgushit, kjo e fundit merret si shembull ilustrues gjatë polemikave për drejtimin që duhet të marrë letërsia shqiptare. Është domethënës fakti që edhe pse polemistët në thelb kanë pikëpamje krejt të kundërta mes syresh, në një farë mënyre unifikohen në qëndrimin ndaj poezisë së Lasgushit. Qëndrimi është më së shpeshti refuzues dhe në rastin më të mirë një pranim i rezervuar. Autorët që mëtojnë publikisht risimin e sistemit letrar shqiptar, parapëlqyesit e modelit realist, e shohin poezinë lasgushiane si “jashtë kohës”, si të tejkaluar dhe jo koherente me nevojat e letërsisë në këtë periudhë¹¹; autorët që qëndrojnë në pozita konservativo-tradicionale

⁸ Po *aty*.

⁹ K. Maloki, “A asht poet Lagush Poradeci?”, *Përpyjekja Shqiptare*, N. 18-26, Tiranë 1938.

¹⁰ K. Maloki, “A asht poet Lasgush Poradeci?”, pjesa e dytë, cit. sipas Krist Maloki, *Oriental apo Okcidental*, Pjejad, Tiranë 2003, f. 55.

¹¹ S. Toto e përkatëson pa mëdyshje poezinë e Lasgushit te modeli i *artit për art* në letërsinë shqiptare: “Si shembëll të kësaj tendence (artit për art. -

për modelet që duhet të lëvrojë sistemi, më së shumti nuk e përmendin emrin e Lasgushit dhe në të rrallë hasim ndonjë vlerësim ambig¹².

Një fakt që tërheq vëmendjen për çështjen e receptimit është qëndrimi kritik, madje shumë kritik që mban Kuteli për një pjesë të krijimtarisë së Lasgushit në vitet '40-të, pra pak vite pas botimit të vëllimit të tij të dytë. Është fjala për disa vjersha (*Tërë ditën më shtëpi, Faqet e dashurisë, Trashëgimi dhe O syt e vashës s'ime*) që poeti i ka botuar në gazetën "Tomori i Vogël"¹³ Si mund të shpjegohet ky qëndrimi i Kutelit, në dukje paradoksal? Mendojmë se duhet kuptuar si kërkesë maksimale ndaj cilësisë poetike të Lasgushit, e cila provon edhe besimin e tij se kemi të bëjmë me një poet mirëfilli. E pra Poeti nuk duhet të "bjerë" kurrësi. Askujt më shumë sesa atij, kritikut dhe njohësit më të thellë të veprës lasgushiane në atë kohë, nuk i takonte të ishte kaq i sertë në kërkesa e vlerësime me autorin e tij të parapëlqyer. Kuteli vjershat e Lasgushit post "Ylli i Zembrës" i "ndan më dysh: një pjesë e shkruar me tonin madhor të poezisë (*Gremina, Engjëjt e parë, Durimi, Dh'u patmë nisur*. - shën. im. E. Gj) dhe pjesa tjetër e një inspirate minore,

shën. ynë) arti në letërsinë t'onë le të mirret "Vallja e Yjeve" e poetit romantik Lasgush Poradeci, e cila më duket se është influencë e tërë e njëj Schlegel-i, njëj Novalis-i, njëj Goethe-je ose e të tjerë fillosofëve romantik të tërëmbëdhjetit e të nentëmbëdhjetit shekull, se sa prodhim i jetës shqiptare dhe i spiritës që duhet të kemi", *art. cit.*; Nuk mungojnë pohime krejt radikale si ky i R. Xhenetit: "S'është më koha të këndojmë "Vallen e Yjeve".", *art i cit.* ; Stefan Morava e sheh si larg realitetit poezinë e Lasgushit, por kjo nuk e pengon ta vlerësojë atë maksimalisht: "Në poezin sigurisht do të gjëjmë vetëm një person, dhe atë ideal, jashtë realitetit; nga ana tjetër poezia e jonë, kur është sidomos lirike, është krejt individuale – Lasgush Poradeci.", *art. i cit.*

¹² Për shembull Filip Ndocaj çmon krijimet e para të Lasgushit dhe kritikon krijimtarinë e tij të vonë: "Është mos është kristalixim i parakohëshëm si ai i Lasgushit të "Valleves" që mbas tyne ka ra më një kaos nga i cili vetëm ne i a pranojshim ndonji jeh muzikaliteti fjale (edhe kjo vargue shpesh nergut per kte), muzikalitet që shpeshherë bahet monotoni shurdhonyjëse. Dikurë kujtuem se Lasgushi do t'ishite poeti i ndiesivet, poeti i zemres, ai i llahtarivvet njerzore kah zani i sublimitetevet t'kangës shpirtit! Tash nga kjo tentativë na kan ardhë një varg teper i gjatë vjerrshash që s'thonë kurrëgjja, që tallen në jehun e njaj fjale, që kujtojnë se ky jeh është gjegja e vetë frymzimit që gjithnji ngelë 'nenkuptuem'!, *Letratyra e jonë, "Fryma" 1942, Nr. 4, f. 158.*

¹³ M. Kuteli, "Disa fjalë mbi vjershat e reja të Lasgushit", në *Shënime letrare*, botim i autorit, Tiranë 1944, f. 27-32.

dekadente”¹⁴. Tehu i kritikës së Kutelit për këtë pjesë të fundit të poezisë lasgushiane, e përcaktuar prej tij si “e dorës së dytë”, prek të gjitha nivelet e tekstit: “inspiratë minore, e lehtë, pa tronditje të brendshme, pa trajtë të lartë”, “lodra fjalësh” etj. Megjithatë Kuteli nuk pranon, me sa duket një opinion që ekzistonte asokohe, se Lasgushi tashmë e ka kryer misionin e tij poetik:

“Po sojesh munt të mburojë një pyetje:

- Në qoftë se vjershëtori i shkrojti ose më fort, se i shtypi, a nuk tregon kjo se kaqe ka për të thënë tani, se kaqe mund tani?

Me të tjera fjalë vihet në bisedim pyetj.a e shterjes së mburimit poetik. Pyetj.a mund të vihet, po mburimi vazhdon të mburojë. Kemi si provë vjershat e pjesës së parë, të inspiratës madhore, që janë të njëjta me prodhimin poetik të vjetër, të cilin e patmë brohoritur dikur, ne, së bashku me njohësit e artit të vertetë”¹⁵.

Shkrimi i sipërcituar i Kutelit i takon vitit 1943¹⁶. E theksojmë këtë sepse pas një viti, në shkrimin polemizues *Poetë dhe detraktorë*, Kuteli duke risjellë në vëmendje rezervat e tij tashmë publike për disa nga poezitë e asokohshme të Lasgushit, rikonfirmon prerë bindjen për vlerat e padyshimta të poezisë së këtij autori:

“Ne të kësaj shoqërije meskine, të ngushtë, tallëse, detraktiste që e njohim tepër afër – më shumë si mish e më pak si frymë – (se s’e ndjejmë edhe se mërzitemi shpejt me një vepër) mundim të bëjmë dëndur konfuzjone midis këtyre pjesëve. Aqë më fort se na ushëtin édhe në vesh prodhimi i tonit minor i periudhës së *Shkëndijës* dhe së *Tomorit të Vogël* ose përpjekja për të blerë do-një kile patate në treg ose mënyra e lidhjes së shallës në qafë.”.

Po ky prodhim edhe shporta e patateve ose kapa kozake që mban në kokë s’kanë qysh errën veprën e tonit madhor, thellësisht lirike e muzikale, pra thellësisht poezi, sikundër se tymi i oxhakut nuk e err diellin. Tymi do tretet shpejt, në erë, njëkohësisht me veprën minore e do na mbetet ç’ka për të mbetur: vepra e tij madhore e *Valles së Yjve* dhe e *Yllit të Zemrës*”¹⁷.

¹⁴ Po aty, f. 28.

¹⁵ Po aty, f. 32.

¹⁶ Këtë datë shënon autori në fundin e shkrimit. Po aty.

¹⁷ M. Kuteli, “Poetë dhe detraktorë”, *Revista Letrare*, Tiranë, 1944, nr. 5. (cituar sipas: *Mendimi letrar shqiptar 1939-1944*, përgat. nga Enver

Nga sa u tha duket qartë se vepra e Lasgush Poradecit ka pasur një receptim të gjerë kritik nga bashkëkohësit, receptim që në sintezë na mundëson ravijëzimin e një raporti specifik, të dykahshëm mes autorit dhe publikut. Raporti qartësohet duke i dhënë përgjigje pyetjeve:

- A ishte në koherencë vepra e Lasgushit me stadin e sistemit letrar shqiptar të asokohshëm?

Përgjigja jonë, pa farë dyshimi, është po. Sipas nesh *sistemi letrar* shqiptar në këtë periudhë është në fazën e konsolidimit të tij, ku prurja e modeleve të reja, mëtimi për risimin e *repertorit*, sidomos nga autorë debutues, është një faktor stabiliteti dhe jo destabiliteti.

- A ishte në koherencë ligjërimi poetik i Lasgushit me “horizontin e pritjes” të asokohshëm?

Situata është e dyzuar, por e kuptueshme. Disa nga poezitë e autorit, sidomos ato ku përqendrohen idetë e konceptet filozofike, jo vetëm për receptuesin masiv, por edhe për një pjesë të kritikës, rezultojnë të parakohshme. E shpjegueshme kjo po të kemi parasysh se publiku shqiptar deri në atë kohë kishte qenë në kontakt me një letërsi shqipe receptimi i së cilës, më së shumti, nuk kërkonte ndonjë shije të hollë estetike. Shembull simptomatik i kësaj gjendjeje janë përfaqësuesit e tipit të dytë, që me gjithë zellin për ta receptuar sa më thellë veprën e Lasgushit, me gjithë vlerësimin maksimal që i japin atij, nuk mund të shkojnë dot në rrokjen totale të tekstit. Për ta, në shumë raste, ai mbetet “i errët”, “i pakuptueshëm”.

Përfaqësuesit e tipit të parë, mbeten interpretuesit më të kthjellët të tekstit lasgushian, jo vetëm për analizën imanente të poezive, por edhe për vendin që ata i paracaktojnë autorit në letërsinë shqiptare. Ata provojnë se ligjërimi lasgushian, megjithëse i imponon receptuesit kërkesa të larta, vjen në kohën e duhur. Çabej e projekton, mprehtësisht, në kohë receptimin e vërtetë të Lasgushit, madje jo vetëm për lexuesin shqiptar, por edhe për atë evropian. Në rastin e letërsisë, jo rrallë projektimi i vlerave në të ardhmen, është vërtetim i vlerave në të tashmen¹⁸.

Muhametaj, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë, 2008, f. 484.

¹⁸ Për leximet e ndryshme të një teksti në kohë të ndryshme, Jausi përdor termat “domethënie aktuale” dhe “domethënie virtuale”. Sipas tij: “Kjo do të thotë që karakteri artistik i një vepre [...] në horizontin e shfaqjes së tij të parë në asnjë mënyrë nuk duhet të jetë i vëzhgueshëm menjëherë. [...] Distanca mes

Nga sa më sipër, duke folur me termat e estetikës së receptimit, duket qartë se Lasgushi me vetëdije të plotë ka synuar *lëvizjen e horizontit të pritjes*¹⁹ fenomen që teorikisht i përket krijuesve më cilësorë. *Distanca mes horizontit të pritjes dhe veprës*, që në rastin tonë shquhet pa vështirësi, vjen si pasojë e vullnetit të autorit për të sjellë një ligjërim artistik ndryshe, i cili afërmendsh bashkëshoqërohet me kosto jo të pakët në receptim, sidomos në nivelin kuptimor, në strukturën e thellë të tekstit. Lasgushi merr përsipër ndryshimin e *përvojës letrare* të publikut, kultivimin e tij me modele që priren nga moderniteti dhe bashkëkohësia. Autori e pohon këtë pa asnjë mëdyshje në vargun e parë të poezisë së parë të librit të tij të parë:

Këng'e lasht'e vjershërisë më pëlqeu aq fare pak..

Nga ana tjetër duhet pohuar se mospërputhja mes tekstit lasgushian dhe përvojës letrare të publikut shqiptar, nuk mund të shtrihet për të gjithë krijimtarinë e tij. Një pjesë e rëndësishme e kësaj krijimtarie, veçanërisht poezitë me temë patriotike, poezitë ku lirika popullore shërben si paratekst, por edhe një pjesë e lirikës erotike, ka një stil të thjeshtë dhe të drejtpërdrejtë. Për pasojë nën prizmin e estetikës së receptimit poezia e Lasgush Poradecit shfaqet dikotomike: njëra pjesë nuk mëton *ndryshimin e horizontit të pritjes*, por kënaq pritjen që është e përcaktuar nga *shija dominante*, ndërsa pjesë tjetër thyen rrënjësisht horizontin e zakonshëm të pritjes letrare; fillimisht ka një publik pothuajse të munguar dhe pak nga pak nis e krijon një publik të vetin²⁰.

receptimit të parë real dhe domethënies virtuale, apo me fjalë të tjera, rezistencës që vepra e re i kundërvendos pritjes së publikut të saj të parë, mund të jetë aq e madhe sa ta ketë të domosdoshëm një proces të gjatë receptimi, për të zhdëmtuar atë që ishte e papritur dhe e pashfrytëzueshme në horizontin primitiv.” Hans Robert Jauss, *Perche la storia della letteratura?*, Gudia Editori, Napoli 2001, f. 62-63.

¹⁹ Për termat e përdoruar këtu, shih: Hans Robert Jauss, *Perche la storia della letteratura?*, Gudia Editori, Napoli 2001.

²⁰ Shih: H. R. Jauss, *vep. e cit.*, f. 46-47.

SUMMARY

*A CLASSIFICATION OF CRITICAL RECEPTION OF LASGUSH
PORADECI'S POETRY*

Lasgush was one of the most popular Albanian literature writers during 1930 – 1940. His first poems were published in the papers of the Albanian colonies in emigration. After these phase he published in most of the Albanian magazines inside country. These poems attracted attention with their original poetical colloquialism, different from the other writers.

The critical reception of the poetry of Lasgush appears contrastive, including extreme different opinions. He can be classified in three levels of valuations: maximum of valuation, up to worshiping him, attempts to an objective valuation with oscillation between enthusiasm and doubt, almost complete denial. The most distinctive representative of the first level is M. Kuteli, of the second level is S. Shundi, of the third level is K. Maloki.

According to the reception aesthetic we can say that the poetry of Lasgush appears in dichotomy: one side doesn't want the change of the expectation horizon, and the other side breaks completely the usual horizon of literature expectation.

